AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Bruto Produkti Vendor sipas Regjioneve Statistikore në Kosovë 2018/2021 ekperimentale

Agjencia e Statistikave te Kosovës (ASK), përkatësisht Departamenti i Llogarive Kombëtare (DLLK), publikon te dhënat eksperimentale të Bruto Produktit Vendor (BPV) sipas Regjioneve Statistikore në nivel III , të harmonizuara sipas Nomenklaturës Territoriale për Statistikat (NUTS), për periudhën 2018-2021

Ky publikim paraqet BVSH-në sipas aktiviteteve ekonomike dhe regjioneve statistikore (NUTS III); BPV-në sipas regjioneve statistikore (NUTS III) si dhe BPV-në për kokë banori sipas regjioneve statistikore (NUTS III).

Në vitin 2021, sipas regjioneve statistikore në nivel III, BPV-ja më çmime aktuale në regjionin e Prishtinës u vlerësua 3,953.5 milion euro, në regjionin e Prizrenit u vlerësua 905.3 milion euro, në regjionin e Pejës u vlerësua 672.8 milion euro, në regjionin e Ferizajit u vlerësua 667.4 milion euro, në regjionin e Gjakovës u vlerësua 617.7 milion euro, në regjionin e Mitrovicës 575.6 milion euro dhe në regjionin e Gjilanit u vlerësua 565.4 milion euro.

BPV për kokë banori në regjionin e Prishtinës për vitin 2021 u vlerësua 8,128 euro, duke shënuar një rritje nominale me 25.7% krahasuar me vitin 2020.